



## **Monitorimi për muajin shtator 2017 mbi ndjekjen e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore**

### **I GJYQËSORI**

#### **PAVARËSIA**

##### **Pribe e shpalli raportin e dytë ekspert**

Nga mesi i muajit, grupi i ekspertëve të Komisionit Evropian, i udhëhequr nga Reinhard Priebe, e shpalli raportin e dytë mbi problemet sistematike me sundimin e drejtësisë në Republikën e Maqedonisë.

Ky raport i përshëndet reformat e iniciuara në fushën e gjyqësorit, ku flet mbi nevojën për përfshirjen dhe transparencën e këtij procesi. Në të njëjtën kohë, raporti i referohet si domosdoshmërisë së planifikimit të duhur ashtu dhe nevojës për të shmangur vonesën e panevojshme në reformat e shumëpritura.

Ekspertët e theksuan edhe njëherë se nuk ka ndaluar kontrolli dhe keqpërdorimi i sistemit të drejtësisë nga një numër i vogël gjykatësish në pozicione të fuqishme të cilët edhe mandej vazhduan të bëjnë presion mbi kolegët e tyre më të rinj dhe të cilët nëpërmjet fuqisë së tyre për të emëruar, vlerësuar, disiplinuar dhe shkarkuar kolegët nga radhët më të ulëta ushtrojnë mbi ta presione për të arritur qëllime të caktuara politike.

Në Raport theksohet se është i domosdoshëm reformimi i procedurave për disiplinimin dhe vlerësimin e gjykatësve, por njëkohësisht jep një vërejtje pozitive se pavarësisht nga abuzimet e vërejtura te një numër i vogël gjykatësish, shumica e gjykatësve e zbatojnë drejtësinë në mënyrë të ndershme dhe të drejtë. Në këtë kuptim, theksohet se edhe pse autoritetet e reja janë të autorizuar, por gjithashtu edhe të detyruara të ndërmarrin veprime të caktuara kundër atyre gjykatësve që e kanë keqpërdorur pozitën e tyre, nuk rekomandohet rizgjedhja e përgjithshme e gjykatësve sepse sjellja e gjyqtarëve në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si diçka universale, dhe “spastrimi” në gjyqësor mund të keqpërdoret politikisht. Prandaj, ai bën thirrje për respektim të plotë të parimit të ndarjes së pushteteve, duke marrë parasysh se gjykatësit që janë nën ndikimin politik duhet t’u nënshtrohen rregullave efektive etike dhe profesionale, ndërsa aty ku ka prova dhe dyshime të bazuara për krime të kryera nga gjykatësit të zbatohen procedurat e duhura në të cilat atyre u është dhënë një urdhër i përhershëm ndalimi të ushtrimit të çfarëdo lloji të ligjit.



Raporti e trajton gjerësisht edhe Këshillin Gjyqësor, ku thotë se Këshilli nuk i përmbush detyrat e veta për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit dhe ai mban një përgjegjësi të madhe për shpërndarjen joadekuate të lëndëve. Ekspertët shprehën edhe shqetësimin se pozita e anëtarit të Këshillit si një funksion i rregullt me kohë të plotë shkakton ndarjen e gjykatësve nga realiteti në gjyqësor. Gjithashtu vërehet mos ndërmarrja e cilado qoftë masave nga Këshilli në drejtim të përsëritjes së procedurave për shkarkimin e disa gjykatësve si dhe masa për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me të cilat është konstatuar shkelje e nenit 6 të Konventës Evropiane për shkak të padrejtësisë në procedurë.

Ndërkohë modeli i Këshillit Gjyqësor lihet të përcaktohet me Strategjinë për reforma në sektorin gjyqësor, grupi ekspert në parim propozon rishqyrtim të thellë të rolit të tij dhe shqyrtim të mundësisë për mbajtje përgjegjësi për anëtarët e tij. Njëkohësisht, përsëritet se është e nevojshme që sistemi ekzistues i matjes dhe vlerësimit të performansave dhe meritës së gjykatësve i cili bazohet mbi kriteret kuantitative të zëvendësohet me një sistem të ri i cili do të fokusohet në cilësinë e drejtësisë, duke u zvogëluar kështu mundësia për manipulim, kurse shkarkimi i gjykatësve do të ishte masa e fundit e cila merret vetëm në raste të jashtëzakonshme.<sup>1</sup>

### **Rivlerësim i punës së kryetarëve të gjykatave**

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë informoi publikun se në vazhdimin e Sesionit të 262 të mbajtur më 20 shtator 2017, janë marrë vendime për kërkesat e parashtruara për rivlerësimin e punës së kryetarëve për vitin 2015 dhe 2016. Këshilli Gjyqësor e përjashtoi publikun kur vendosi për vlerësimin.<sup>2</sup>

### **Paanësia**

#### **Rishqyrtim i domosdoshëm i Sistemit AKMIS – rekomandim i raportit të dytë të Pribes**

Në raportin e dytë të ekspertëve të grupit të Pribes, ekspertët shprehën dyshimet e tyre mbi kredibilitetin e sistemit AKMIS për shpërndarjen e lëndëve, me theks të veçantë në funksionimin e tij në Gjykatën Themelore Shkup 1. Sipas tyre, ka mundësi që ai të manipulohet në disa mënyra, dhe kjo: 1) shpërndarja e gjykatësve “të papërshtatshëm” në njësi të tjera kur duhet të shpërndahen lëndët

<sup>1</sup>[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14\\_seg\\_report\\_on\\_systemic\\_rol\\_issues\\_for\\_publication.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf)

<sup>2</sup>[http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/90a377ec-4d35-4bb7-975b-8635d4dd0597/lut/p/z1/tVPRbtMwFP0WHvLo2Int20EtMLqQ0JVpBBQ\\_VHbipmZLnCVesvH1uBIS6gotaOAXy9I55557zzUUcA1FKOdTS2dsK-8uxDJrkkBPH36ANfXKQoywmeXX\\_8FBFG4JdDwGW04h6wypN0PovzHENxmv8ZCijK1nVuB4vBjtpmtmsADQ9VgDpbatfKAI16cCZAKZKYMVOCUmEKiFIMplwqgBNMK1JViKZsL9eVpolFingsZZmAVEmP3goUSIU5wCiNK8ViFKsj-8f-9vbRb06GfvBPAMS58YlZcShxvGEF1AY1YRT2YQo5BGmOOYJJTHhLin2CWat77uGotdb3es-fOh9sDvnuuF1gAI0TVNYW1vf6bc0TYB-RdnZwcH1IRIWvnn209lqPmPe2bulZvw6vpn76YxGTzBvbd\\_4Xbr5y2y8wLMKz-Y3i15Y4bT8Ff2\\_8uyF8otzy-VzNF\\_v70Xmf5htnX70Ef6LL-Z14375dun3o5NuB0y7tXD9R9SuyRuOnwy43S4dVbRuNhdvrkCxGL\\_5S6inKXv1Hb5HYgg/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urilc=wcm%3Apath%3A%2Fsovet\\_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F90a377ec-4d35-4bb7-975b-8635d4dd0597](http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/90a377ec-4d35-4bb7-975b-8635d4dd0597/lut/p/z1/tVPRbtMwFP0WHvLo2Int20EtMLqQ0JVpBBQ_VHbipmZLnCVesvH1uBIS6gotaOAXy9I55557zzUUcA1FKOdTS2dsK-8uxDJrkkBPH36ANfXKQoywmeXX_8FBFG4JdDwGW04h6wypN0PovzHENxmv8ZCijK1nVuB4vBjtpmtmsADQ9VgDpbatfKAI16cCZAKZKYMVOCUmEKiFIMplwqgBNMK1JViKZsL9eVpolFingsZZmAVEmP3goUSIU5wCiNK8ViFKsj-8f-9vbRb06GfvBPAMS58YlZcShxvGEF1AY1YRT2YQo5BGmOOYJJTHhLin2CWat77uGotdb3es-fOh9sDvnuuF1gAI0TVNYW1vf6bc0TYB-RdnZwcH1IRIWvnn209lqPmPe2bulZvw6vpn76YxGTzBvbd_4Xbr5y2y8wLMKz-Y3i15Y4bT8Ff2_8uyF8otzy-VzNF_v70Xmf5htnX70Ef6LL-Z14375dun3o5NuB0y7tXD9R9SuyRuOnwy43S4dVbRuNhdvrkCxGL_5S6inKXv1Hb5HYgg/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urilc=wcm%3Apath%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F90a377ec-4d35-4bb7-975b-8635d4dd0597)



delikate; 2) largimi me pushim mjekësor apo ndonjë lloj tjetër mungueseje në periudhën e shpërndarjes së lëndëve të tilla nga gjykatësit të cilët kanë dashur të shmangin presionet; 3) mundësia që dallimet në procedura të cilat mbahen sipas KPP-së së vjetër dhe të re të shfrytëzohen me qëllim që të lehtësohet manipulimi me sistemin, si dhe 4) keqpërdorimi i sistemit nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta nga personat e autorizuar, siç janë kryetarët e gjykatave. Duke pasur parasysh se nuk është bërë asnjëherë mbikëqyrje e thellë mbi funksionimin e sistemit AKMIS, grupi ekspert propozon të bëhet një mbikëqyrje e tillë, pa përzierje politike, dhe sipas nevojës me pjesëmarrje të institucioneve dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë, mbikëqyrje e cila do të ketë për qëllim të vërtetojë se a janë kryer veprime eventuale kundërligjore.

### **Gjykata e Lartë e shtyu përsëri seancën publike për rastin “Monstrum”**

Gjykata e Lartë e Republikës së Maqedonisë e shtyu edhe njëherë seancën publike për rastin me vrasjen e shumëfishtë të Liqeni i Smillkovës, sepse nuk janë përmbushur kushtet për mbajtjen e seancës publike. Më konkretisht, Gjykata e shpalli se ka marrë lajmërim nga një prej burgjeve se nuk ka pasur mundësi për transport të një prej të akuzuarve nga institucioni edukues.

Seanca publike më parë është shtyrë disa herë, me arsyetime të ndryshme si sëmundje të papritura të gjykatësve e të tjerë. Seanca është caktuar më 3 tetor 2017.<sup>3</sup>

### **U arrestua Igor Jug për të cilin ekzistojnë dyshime se ka qenë udhëheqës i grupit të dhunuesve në Kuvend më 27 prill 2017.**

Në qendër të Kumanovës është arrestuar Igor Jug, një prej dhunuesve i cili hyri në Kuvend më 27 prill të këtij viti, pasi ai për një kohë të gjatë nuk ishte në dispozicion të organeve të ndjekjes. Atij i është përcaktuar paraburgim për shkak të pjesëmarrjes së tij në evenimentet e përgjakshme në Kuvendin e Maqedonisë “të enjten e përgjakshme” ku ishte i veshur me bluzë të zezë me simbol të organizatës kroate proustashe “HOS”.

Këtë informacion e vërtetoi edhe MPB-ja, që theksoi se arrestimin e tij e kërkuan nga Prokuroria Publike Themelore më 16 maj në lidhje me ngjarjet në Kuvend<sup>4</sup>.

Përndryshe, Igor Jug akuzohet për veprën penale “pjesëmarrje në turmë që ndalon personin zyrtar në zbatimin e veprimit zyrtar”, e dënueshme sipas nenit 384 p. 1 i KP-së së Maqedonisë.

<sup>3</sup>[http://www.sud.mk/wps/portal/vsrm/sud/vesti/2cd7b8a6-da7c-43b2-9a74-56f9c37e8bec!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6HWPtHgsZllpEYcL6QrquQJV1g5Wh\\_nrLk4lGwOB9u8n5uOfmYI7nmBvR6JWwujRi4\\_aUh4uwHwRA7-CeTp46wGlgdBoxgJig2SIaVweYn-Y\\_Y465NLaya5xW-2yj5aJ49aDe5x5UpVTWCA8aVVvtgS9zklERolwQiYJW5qNikAC1w2Ukw0TRTMmjXiV1jtOLoLzAY\\_3wy\\_DwPH5OUjqLMiXxXjQI8CS-KbN6KM\\_Zu6HjVYHnJhyV7iXT\\_6YYPDD4VuIYftKh5Pyk9vwSvnhuY64EuqX7ZYz15TSWpVm8fxqKE\\_d2o01q5e4Vdl22WJZ5fRK2KpKcTd2Q-Og-o383oYbosZrT-BHnt5Vkl/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic\\_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F2cd7b8a6-da7c-43b2-9a74-56f9c37e8bec](http://www.sud.mk/wps/portal/vsrm/sud/vesti/2cd7b8a6-da7c-43b2-9a74-56f9c37e8bec!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6HWPtHgsZllpEYcL6QrquQJV1g5Wh_nrLk4lGwOB9u8n5uOfmYI7nmBvR6JWwujRi4_aUh4uwHwRA7-CeTp46wGlgdBoxgJig2SIaVweYn-Y_Y465NLaya5xW-2yj5aJ49aDe5x5UpVTWCA8aVVvtgS9zklERolwQiYJW5qNikAC1w2Ukw0TRTMmjXiV1jtOLoLzAY_3wy_DwPH5OUjqLMiXxXjQI8CS-KbN6KM_Zu6HjVYHnJhyV7iXT_6YYPDD4VuIYftKh5Pyk9vwSvnhuY64EuqX7ZYz15TSWpVm8fxqKE_d2o01q5e4Vdl22WJZ5fRK2KpKcTd2Q-Og-o383oYbosZrT-BHnt5Vkl/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F2cd7b8a6-da7c-43b2-9a74-56f9c37e8bec)

<sup>4</sup><http://fokus.mk/vfrnhymvr-potvrđi-deka-igor-jane-e-uapsen/>



Disa ditë para arrestimit të tij, kundërzbuluesi serb, Goran Zhivaleviq, i cili ishte gjithashtu në Kuvend gjatë protestave më 27 prill tha se Igor Jug ishte njeriu i cili duhej ta vriste liderin e LSDM-së, Zoran Zaev.

### **Gjykata Penale i përcaktoi masën paraburgim kryetarit të komunës “Pustec”, Edmond Temelko**

Gjykata Themelore Shkup 1 njoftoi se Këshilli Penal i Njesisë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin në të njëjtën gjykatë, duke vepruar me propozimin e PSP-së për caktimin e masës së paraburgimit kundër të akuzuarit Edmond Temelko, në një seancë jopublike të mbajtur më 25 shtator 2017, menjëherë pas pranimit të kërkesës në gjykatë, mori vendim me të cilin pranohet propozimi i PSP-së dhe i caktoi të pandehurin masë paraburgimi prej 30 ditësh nga data e kërkitimit dhe privimit të tij nga liria, për shkak të ekzistimit së arsyeve të parashikuara në nenin 165 paragrafi 1 p. 1 të LPP-së.<sup>5</sup>

Ai njëherë është arrestuar, por pastaj është liruar nga gjykata. Gjykata e Apelit më 21 korrik 2017 mori vendim që t’ia marrë pasaportën Temelkos me obligim që të paraqitet një herë në javë në Gjykatën Penale. Disa media nxorën informacione se MPB e ka arrestuar Temelkon, por për këtë nuk ka vërtetim nga Ministria.

Temelkoja është një prej të akuzuarve të Prokurorisë Speciale Publike për vepra penale në zgjedhje dhe votime. Në rastin “Titanik”, PSP-ja hapi procedurë hetimore për një sërë parregullsish në votime (shoqërim kriminal, shkelje e të drejtës së zgjedhjes, shkelje e të drejtës së lirisë së vendimit të votuesve, shkatërrim i materialit zgjedhor dhe keqpërdorim i mjeteve për programin zgjedhor) lidhur me zgjedhjet lokale në vitin 2013. Në shkurt të vitit 2013, kur është prezantuar rasti para publikut, prokurorja Fatime Fetaj, tha se personat e përfshirë në këtë hetim e kanë shfrytëzuar ndikimin edhe në nivel lokal edhe në atë shtetëror dhe kanë krijuar grup për kryerje të veprave penale, që të mundësojnë fitoren e një partie të caktuar politike në zgjedhje.

### **Gjykata Penale i refuzoi kërkesat e Gruevskit dhe Mijallkovit për kthim të pasaportave**

Këshilli penal në Njesisë për Krim dhe Korrupsion të Organizuar i Gjykatës Themelore Shkup 1 e hodhi poshtë kërkesën e ish-kryeministrit Nikolla Gruevski që t’i kthehet pasaporta si të pabazë. Gruevski mbetet pa pasaportë dhe i është ndaluar dhënia e dokumentit të ri për udhëtim, për kalim të kufirit shtetëror, kure përkohësisht i është marrë edhe pasaporta diplomatike.

<sup>5</sup>[http://www.sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/9deab79e-33e5-47b4-bb97-67bd8b090c7f!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6hbF2j4UMEEWiMMf6QtqtgyrrBpSh\\_nrlk4lGwOB9u8n5uOfmYI7nmBvR6KWwujji7faUB4tg4PtA7-CeTp-6wClgdBYygljg5BRg0AfMT\\_OfMcc8M7a2K5zWe7nW2aJ89WC3zz2oq0xZlzo1M5qD8JcCUIChdpt1UE-kT6SMiQoIDKnEkLISHHUqzOd4\\_QidHlu4PF--GUYOD4\\_B0mdBfmymAz7BFgc3XQYfWxNmPtho9UBx6balu7l0z8mGP5w-Bzi1LnS4aT89Da4Un50riOuhPpls-HMNaUyVr1ZPP-Xqjih1nbcGy\\_dvcKukDZFhecXUesyLmn7HZmP7gMa9CQ9zloyobtPglwbYA!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic\\_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F9deab79e-33e5-47b4-bb97-67bd8b090c7f](http://www.sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/9deab79e-33e5-47b4-bb97-67bd8b090c7f!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6hbF2j4UMEEWiMMf6QtqtgyrrBpSh_nrlk4lGwOB9u8n5uOfmYI7nmBvR6KWwujji7faUB4tg4PtA7-CeTp-6wClgdBYygljg5BRg0AfMT_OfMcc8M7a2K5zWe7nW2aJ89WC3zz2oq0xZlzo1M5qD8JcCUIChdpt1UE-kT6SMiQoIDKnEkLISHHUqzOd4_QidHlu4PF--GUYOD4_B0mdBfmymAz7BFgc3XQYfWxNmPtho9UBx6balu7l0z8mGP5w-Bzi1LnS4aT89Da4Un50riOuhPpls-HMNaUyVr1ZPP-Xqjih1nbcGy_dvcKukDZFhecXUesyLmn7HZmP7gMa9CQ9zloyobtPglwbYA!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F9deab79e-33e5-47b4-bb97-67bd8b090c7f)



Vendimi, siç informojnë nga Gjykata, është marrë me seancë të mbyllur, kurse kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh te Gjykata e Apelit në Shkup.<sup>6</sup>

Gjykata Penale refuzoi t'ia kthejë pasaportën ish-drejtorit të policisë sekrete, Sasho Mijallkov, kurse kërkesën e tij gjykata e vlerësoi si të pabazuar.

Me këtë vendim të Gjykatës, mbeten në fuqi masat e kujdesit – Mijallkov të paraqitet njëherë në javë në gjykatë, si edhe marrja e përkohshme e dokumentit të udhëtimit për kalim të kufijve shtetërorë dhe ndalimi për dhënie të dokumentit të ri apo të ndonjë dokumenti tjetër.

PSP-ja kërkoj paraburgim për Gruevskin për rastin “Titanik”, por Gjykata Themelore Shkup 1 i përcaktoi masa kujdesi. Mijallkov dhe Gruevski janë të akuzuarit e parë në rastin “Target – Kështjella”.

### **Gjykata Penale i veçoi bisedat e përgjuara nga dëshmitë në “Toplik”, “Tenderë” dhe “Tortura” si të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe të papërdorshme në procedura**

Këshilli për vlerësim të aktakuzës së Gjykatës Themelore Shkup 1, i cili vepron në vlerësimin e aktakuzës së PSP-së për lëndën “Tenderë”, duke vepruar sipas kërkesës për veçim të shënimeve të lëndës së dëshmisë të mbledhur në mënyrë të paligjshme të dhënë në ankesën kundër aktit, ndërsa me obligim zyrtar, mori vendim me të cilin veçohen nga shkrimet e lëndës dëshmitë prej bisedave telefonike si dëshmi e mbledhur në mënyrë të paligjshme dhe me shkelje të të drejtave dhe lirive të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Të njëjtin vendim me të njëjtin arsyetim Këshilli e ka marrë për propozimin e mbrojtjes në lëndët “Tortura” dhe “Toplik”.<sup>7</sup>

<sup>6</sup>[http://www.sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/a989cceb-90ec-4747-9a51-e3d889b003ca!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6YYO1j4UMEEWiA8f6QrpSoMq6AWUov97yZKJxYPC-3eR83HNzMMczzl2o9EpYXRixcXvK2\\_N2PwiA3MMDiZ87wCIIlyYQygCjESR2g3wPM6\\_kvmGMujS3tGqflldtoOc\\_fPNgfFh6UhVTWCA8qtbfaA0EJIVJliiKSKAiDEFHRaiDILwihGYAvxVmvIHqB06vQyaWA5\\_vhl2Hg-PwSJHUW4ZfFeNaLgU2jRouRp-aYuR9WWWh3x1BS73L08\\_mOCwQ-HbyGGrRsdauXju\\_aN8sNLHXEI1K\\_bLWuKYWx6t3i2b9UxQk3d6PuaOXuFXaNtFkWeHYVtcynOfE\\_kDI1HIG\\_m5HjZJk\\_nZP8JHIdogq!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic\\_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Fa989cceb-90ec-4747-9a51-e3d889b003ca](http://www.sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/a989cceb-90ec-4747-9a51-e3d889b003ca!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6YYO1j4UMEEWiA8f6QrpSoMq6AWUov97yZKJxYPC-3eR83HNzMMczzl2o9EpYXRixcXvK2_N2PwiA3MMDiZ87wCIIlyYQygCjESR2g3wPM6_kvmGMujS3tGqflldtoOc_fPNgfFh6UhVTWCA8qtbfaA0EJIVJliiKSKAiDEFHRaiDILwihGYAvxVmvIHqB06vQyaWA5_vhl2Hg-PwSJHUW4ZfFeNaLgU2jRouRp-aYuR9WWWh3x1BS73L08_mOCwQ-HbyGGrRsdauXju_aN8sNLHXEI1K_bLWuKYWx6t3i2b9UxQk3d6PuaOXuFXaNtFkWeHYVtcynOfE_kDI1HIG_m5HjZJk_nZP8JHIdogq!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Fa989cceb-90ec-4747-9a51-e3d889b003ca)

<sup>7</sup>[http://www.sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/a989cceb-90ec-4747-9a51-e3d889b003ca!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6YYO1j4UMEEWiA8f6QrpSoMq6AWUov97yZKJxYPC-3eR83HNzMMczzl2o9EpYXRixcXvK2\\_N2PwiA3MMDiZ87wCIIlyYQygCjESR2g3wPM6\\_kvmGMujS3tGqflldtoOc\\_fPNgfFh6UhVTWCA8qtbfaA0EJIVJliiKSKAiDEFHRaiDILwihGYAvxVmvIHqB06vQyaWA5\\_vhl2Hg-PwSJHUW4ZfFeNaLgU2jRouRp-aYuR9WWWh3x1BS73L08\\_mOCwQ-HbyGGrRsdauXju\\_aN8sNLHXEI1K\\_bLWuKYWx6t3i2b9UxQk3d6PuaOXuFXaNtFkWeHYVtcynOfE\\_kDI1HIG\\_m5HjZJk\\_nZP8JHIdogq!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic\\_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Fa989cceb-90ec-4747-9a51-e3d889b003ca](http://www.sud.mk/wps/portal/oskopje1/sud/vesti/a989cceb-90ec-4747-9a51-e3d889b003ca!/ut/p/z1/rVJdT8lwFP01e2x6YYO1j4UMEEWiA8f6QrpSoMq6AWUov97yZKJxYPC-3eR83HNzMMczzl2o9EpYXRixcXvK2_N2PwiA3MMDiZ87wCIIlyYQygCjESR2g3wPM6_kvmGMujS3tGqflldtoOc_fPNgfFh6UhVTWCA8qtbfaA0EJIVJliiKSKAiDEFHRaiDILwihGYAvxVmvIHqB06vQyaWA5_vhl2Hg-PwSJHUW4ZfFeNaLgU2jRouRp-aYuR9WWWh3x1BS73L08_mOCwQ-HbyGGrRsdauXju_aN8sNLHXEI1K_bLWuKYWx6t3i2b9UxQk3d6PuaOXuFXaNtFkWeHYVtcynOfE_kDI1HIG_m5HjZJk_nZP8JHIdogq!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Fa989cceb-90ec-4747-9a51-e3d889b003ca)



## **Gjykata e Apelit Shkup lejoi që bisedat e përgjuara të përdoren si dëshmi në lëndën “Trista”**

Këshilli Penal i Gjykatës së Apelit Shkup shpalli se pas mbajtjes së seancës më 18 shtator 2017, kurse në lidhje me lëndën e njohur për publikun si “Trista”, e formuar pas aktakuzës së ngritur kundër të akuzuarit Gj.P., është marrë vendim me të cilin ajo e miraton ankesën e Prokurorisë Speciale Publike.<sup>8</sup>

Bisedat e përgjuara të cilat publiku nuk kishte mundësi t’i dëgjonte deri më tani, do të jenë dëshmi në procedurën gjyqësore në rastin “Trista”. Gjykata e Apelit me vendimin e vet në mënyrë meritore vendosi ta hedhë poshtë propozimin e të akuzuarit Gj.P. nga S që prej shkresave të lëndës të veçohet regjistrimi audio nga telefoni kontaktues, si dëshmi e mbledhur në mënyrë të paligjshme, me arsyetim se dëshmia e dhënë është dëshmi e mbledhur në mënyrë ligjore dhe si e tillë mund të përdoret si dëshmi në procedurën penale për këtë lëndë. Njëkohësisht, me këtë ka ndryshuar edhe vendimi i Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup me të cilin e njëjta dëshmi është veçuar nga shkresat e lëndës si dëshmi e mbledhur në mënyrë të paligjshme.

Ky është rasti i dytë i një lënde të PSP-së për të cilën Gjykata e Apelit ka vendosur në mënyrë pozitive pas kërkesës së PSP-së që bombat të jenë material dëshmitar. Para pothuajse dy muajsh gjykatësit e kësaj gjykate i pranuan bombat si dëshmi në rastin e njohur si “Shuplaka në Komunën Qendër” ku akuzohet ish-kryeministri Nikolla Gruevski, i cili nëpërmjet anëtarit të partisë së tij Mile Janakievskit porositi dhunë mbi kryetarin e komunës “Qendër”, gjatë protestave në vitin 2013. Atë kohë nga partia VMRO-DPMNE reagan se Gjykata e Apelit iu nënshtrua presioneve politike të qeverisë së re, kurse nga gjykata arsyetuan se pranimi i bombave nuk është diçka e re dhe tashmë ka praktikë gjyqësore të vendosur. Si shembull e morën rastin “Spiun” ku si dëshmi në seancat gjyqësore janë përdorur materialet e marra në mënyrë jolegale.

### **Kompetenca**

#### **U mbajt mbledhje e katërt dhe e pestë e Këshillit për Reforma në Sektorin e Gjyqësorit**

Në takimin e katërt ekspert anëtarët e Këshillit i dhanë vërejtjet përfundimtare dhe konkrete në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së Draft-Strategjisë dhe Planit aksionar dhe u rekomanduan Grupit të Punës dhe Ministrisë së Drejtësisë që të fillojnë me prezantimin e tyre publik, q të njihet publiku më i gjerë me këto draft-dokumente dhe të mundësohet hapësira për propozime, vërejtje dhe plotësime nga të gjitha palët e interesuara në procesin e finalizimit të tyre.

<sup>8</sup>[http://www.sud.mk/wps/portal/asskopje/sud/vesti/07942c21-c9fb-44ae-992a-5c03637e3ba6/!ut/p/z1/rVLJbslwEP2aHC0PWZ2jQSylpagNKYkvyDEJuCVOICa0fH3NqVKrAhWd20hvmTd6mOEEM8VbueJaVopvzJ4yf-EPXRfIPTyQ6LkLtA8BmYUuoB\\_g-TnAcACYnee\\_YlaZULrWa5zW-2wjxaJ8s6DZLy2oK5FrXS1o80ZLCyAIXVvYHSTCikOuy3MUHjZHngDhd4Lcybh\\_0quFXOLOkvT8UsDT\\_fDLUDB8dgmSGo\\_vgy2I6GgRA437Ho-TJnlLzw1bmBxyralealOd\\_TDD64fAtxNi70eGsfHTn3yg\\_vtQRUOL5ut0yappSKZ2\\_a5z8S1WMSL2b9CYrcy\\_XayRVUeHkKmpdxivXppA6dh\\_RsJeRw6wo56T5BLldCx4!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic\\_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F07942c21-c9fb-44ae-992a-5c03637e3ba6](http://www.sud.mk/wps/portal/asskopje/sud/vesti/07942c21-c9fb-44ae-992a-5c03637e3ba6/!ut/p/z1/rVLJbslwEP2aHC0PWZ2jQSylpagNKYkvyDEJuCVOICa0fH3NqVKrAhWd20hvmTd6mOEEM8VbueJaVopvzJ4yf-EPXRfIPTyQ6LkLtA8BmYUuoB_g-TnAcACYnee_YlaZULrWa5zW-2wjxaJ8s6DZLy2oK5FrXS1o80ZLCyAIXVvYHSTCikOuy3MUHjZHngDhd4Lcybh_0quFXOLOkvT8UsDT_fDLUDB8dgmSGo_vgy2I6GgRA437Ho-TJnlLzw1bmBxyralealOd_TDD64fAtxNi70eGsfHTn3yg_vtQRUOL5ut0yappSKZ2_a5z8S1WMSL2b9CYrcy_XayRVUeHkKmpdxivXppA6dh_RsJeRw6wo56T5BLldCx4!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F07942c21-c9fb-44ae-992a-5c03637e3ba6)



Këshilli dha rekomandim, që pas përfundimit të këtyre aktiviteteteve, të vazhdohet me procedurën për miratim të Draft-Strategjisë me Planin Aksionar, në mënyrë transparente dhe inkluzive.

Këshilli për Reforma në Sektorin e Gjyqësorit japi edhe dis çështje të rëndësishme të cilat kanë për qëllim edhe veprime te Qeveria e Republikës së Maqedonisë me të cilat do të kthehet besimi i qytetarëve te sistemi gjyqësor.<sup>9</sup>

Në seancën e pestë janë shqyrtuar Propozim-ligji për amnisti, Propozim-ligji për ndryshim të ligjit për Këshillin Gjyqësor në Republikën e Maqedonisë dhe Propozim-ligji për shfuqizim të Ligjit për Këshillin për përcaktim të fakteve dhe ngritje të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë së gjykatësit. Këshilli e pranoi idenë e miratimit të këtyre ligjeve dhe nxori përfundim, Propozim-ligji për amnisti të rishqyrtohet nga Këshilli sepse ai është akoma në shqyrtim nga publiku dhe nuk përjashtohen ndryshime shtesë nëse eventualisht merren sugjerime dhe vërejtje.

Në suazat e mbledhjes së anëtarëve të Këshillit për Reforma në Sektorin e Gjyqësorit u pah edhe çështja për të a.q. “rastet e montuara politikisht”. Mendimet e anëtarëve të Këshillit ishin në drejtim të miratimit të një dispozite me të cilën do të rregullohet kjo çështje si edhe të gjendet zgjidhje për mënyrën me të cilën do të përcaktohet se a do të jetë ndonjë rast në ndjekje penale lëndë e rihapjes së procesit gjyqësor.<sup>10</sup>

## **U mbajt prezantimi i Draft-strategjisë për reforma në sektorin gjyqësor me Plan aksionar për periudhën 2017-2021**

Grupi i punës për përgatitjen e Draft-strategjisë për reforma në sektorin gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë në Ohër mbajti takim pune ku është prezantuar Draft-strategjia për reforma në sektorin gjyqësor së bashku me Planin aksionar.<sup>11</sup>

Ministri Saliji theksoi se Qeveria ka vendim të fuqishëm dhe konsensus politik për reforma të vendosura në gjyqësor. Kryetarja e grupit të punës, prof. dr. Ana Pavlovska-Daneva e prezantoi thelbin e Draft-strategjisë, duke i theksuar drejtimit kryesore dhe konkrete për reforma në sektorin gjyqësor. kështu, pavarësia dhe paanshmëria, përparimi i cilësisë së institucioneve që e përbëjnë sektorin e gjyqësorit, përgjegjësia,efikasiteti dhe transparenca, ishin vendosur si parime prijëse gjatë krijimit të këtij dokumenti strategjik.

## **II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT**

### **PSP-ja e shpalli raportin e katërt mbi punën e vet**

Prokuroria Speciale Publike (PSP) e shpalli raportin e katërt për punën e vet, me të cilin informohet se gjatë gjashtë muajve të fundit janë regjistruar 142 procedura të reja parahetimore, prej të cilave 49 janë formuar me iniciativë personale, kurse 93 lëndë janë formuar në bazë të fletëparaqitjeve nga dërgues të

<sup>9</sup>[http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1383](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1383)

<sup>10</sup>[http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1392](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1392)

<sup>11</sup>[http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1384](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1384)



tjerë. Sipas statistikave të prezantuara, momentalisht prokuroret dhe prokurorët punojnë gjithsej 99 procedura parahetimore.<sup>12</sup>

Sipas raportit, procedurat e reja parahetimore kanë të bëjnë me ndjekjen e paligjshme të komunikimeve, si dhe paligjshmërinë në lidhje me financimin e mediave, keqpërdorimin e mjeteve financiare për fushatë zgjedhore, keqpërdorime të ndryshme të procedurave për furnizime publike, fshehje tatimi, pastrim parash, veprime të ndryshme korruptuese dhe keqpërdorime të ndryshme të pozitës zyrtare dhe autorizimeve dhe hetime financiare. Duhet të kihet parasysh se një pjesë e tyre janë hapur para periudhës së raportit, kurse një pjesë të tyre në këtë periudhë ka kaluar në fazën e hetimeve.

Prokurorja speciale publike, Katica Janeva, në këtë raport theksoi se edhe në periudhën e ardhshme do të vazhdojnë të punojnë në mënyrë aktive. Ajo theksoi se qëllimi i PSP-së është që edhe në periudhën e ardhshme të hapë hetime të reja dhe të ndërmarrë veprime ligjore në drejtim të hetimit të veprave penale që janë në kompetencë të tyre. Përveç kësaj, theksi do të vihet edhe te dëgjimi dhe përpunimi i audio fajleve dhe hapja e procedurave të reja parahetimore.

Janeva rikujtoi se në periudhën e raportit janë ngritur 18 akuza për 19 lëndë kundër 120 personave gjithsej.

### **Fillimi i procesit për Kontroll të zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit – Cikli i dytë**

Ministria e Drejtësisë informoi se ka nisur procesi për kontroll të zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (cikli i dytë), i cili do të përfshijë kapitujt II “Masa parandaluese” dhe V “Pagimi i pronës”. I Njëjti sipas Ministrisë, fillon të zbatohet me kryerjen e vetë vlerësimit më 18 shtator 2017. Në këtë kontekst, Ministria u bëri thirrje individëve dhe organizatave të interesuara që të informojnë në lidhje me aktivitetet në suazat e procesit nëpërmjet koordinitorit të procesit në Republikën e Maqedonisë.<sup>13</sup>

### **PROCEDURA GJYQËSORE AKTUALE**

#### **“Lagjja e trimave” - KOK 127/15**

Gjatë muajit shtator janë mbajtur gjashtë seanca gjithsej për lëndën me titull pune “Lagjja e trimave” (më 14, 18, 20, 22, 26 dhe 28.09.2017). Seancat në muajin shtator vazhduan me thënien e fjalëve përfundimtare, ndërsa seanca për shpalljen e aktvendimit është caktuar për më 17 tetor 2017.

#### **KOK-95/16 – Procedura e veçuar “Lagjja e trimave”**

<sup>12</sup><http://www.ionsk.mk/wp-content/uploads/2017/09/%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88-15.09.2017.pdf>

<sup>13</sup>[http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1389](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1389)





Në seancën e 11 shtatorit 2017 Prokuroria Publike dhe mbrojtja propozuan dëshmi në plotësim. Nga PP-ja janë propozuar dëshmi materiale (CD nga aksioni policor dhe ekspertiza e mjekësisë gjyqësore për lëndimet e të rënëve), kurse mbrojtja propozoi të dëgjohen dëshmitarë (përfaqësues të MPB-së të pranishëm gjatë arratisjes së të akuzuarit dhe politikanë).

Seanca e 21 shtatorit është shtyrë.

Në seancën e 27 shtatorit gjykata mori vendim t'i pranojë dëshmitë e propozuara në plotësim nga PP-ja, kurse i hodhi poshtë dëshmitë e propozuara nga mbrojtja sepse nuk ka indikacione se dëshmitarët e propozuar kanë informacione të rëndësishme për ngjarjen. Pastaj gjykata mori vendim që të hapet dëshmia e klasifikuar (CD nga aksioni policor), prandaj publiku është përjashtuar. Datat për fjalët për fjalët përfundimtare do të shpallen mandej.

#### **“Pavle”- K-1525/16**

Në seancën e mbajtur më 1 shtator 2017 përfaqësuesi i Ministrisë së dëmtuar, Ministrisë së Kulturës, dorëzoi ekspertizë të re mbi dëmin e ndodhur i cili është vlerësuar mbi 15.600 denarë. Për shkak të mungesës së prokurorit publik, si dhe përfaqësuesit të Avokatit Shtetëror seanca është shtyrë për më 2 tetor në orën 9.30 minuta.

#### **“Rover” - K-2454/15**

Seanca më 6 shtator 2017 u shty për datën 15 nëntor 2017, për shkak të mungesës së prokurorit publik në procedurë, si dhe mungesës së njërit prej të akuzuarve.

#### **“Kështjella 2”-K- 1905/16**

Seanca e 26 shtatorit 2017 u shty, sepse gjykata nuk kishte marrë ende informacion nga MPB-ja se i akuzuari është në arrati, d.m.th. ai nuk është në dispozicion të organeve të ndjekjes. Seanca e ardhshme është caktuar për datën 2 tetor 2017.

#### **“Komuna Qendër - K 1904/16**

Seanca e 28 Shtatorit 2017, për lëndën me titullin e punës "Komuna e Qendrës" u shty menjëherë për shkak të faktit se disa nga të akuzuarit nuk ishin të pranishëm në gjykim. Seanca e ardhshme është caktuar për më 20 nëntor 2017.

### **III TË DREJTAT THEMELORE**

#### **1. Liria e shprehjes dhe pluralizmi në media**

Gjatë muajit shtator vazhdoi trendi i targetimit të punonjësve në media. Automobili i gazetares së revistës javore “Fokus” Viki Klinçarova, është dëmtuar nga një kryerës i panjohur përgjatë anës së djathtë me një objekt të fortë.<sup>14</sup> Ajo theksoi se vite me radhë ka marrë ofendime, shpifje dhe kërcënime

<sup>14</sup><http://fokus.mk/oshteten-avtomobilot-na-novinarka-vo-fokus/>



nga persona të cilët janë fajtorë para ligjit, kurse për të cilët ajo ka shkruar në medium, kurse në periudhën e kaluar, nga një person me dosje kriminale, ishte cak i kërcënimeve verbale, ofendimeve dhe shpifjeve për shkak të një teksti të botuar në “Fokus”. “Rastin e kam paraqitur dy herë në polici, brenda tri ditëve. Kur telefonova për herë të dytë në stacionin policor, nëpunësi dezhurn më tha se pas paraqitjes së parë, ende nuk kanë kontaktuar me personin e paraqitur, sepse ka qenë festë.” Ajo e tregoi deklaratën e nëpunësit policor “Kërcënim është kur t’ju vinë me thikë dhe me pistoletë, ndërsa jo kur ju shkruajnë diçka në Fejsbuk”. Gazetarja deklaroi se qëndrimi i tillë tek ajo ka krijuar mosbesim te institucionet: “Nuk mund të them me siguri a është ngatërruar personi edhe në këtë rast, me dëmtim të automobilit, por është fakt se arriti të bëjë një hajkë të vërtetë në rrjetet sociale kundër meje, ku e kanë mbështetur edhe të afërm të tij, por edhe miq dhe të afërm të personave për të cilët në të kaluarën ka ndodhur të shkruajmë për shkeljet e tyre, të cilat rregullisht janë regjistruar në buletinet ditore të MPB-së.”

SHGM-ja e dënoi këtë akt duke e vlerësuar si sulm të drejtpërdrejtë mbi lirinë e fjalës dhe të drejtën e informimit dhe theksoi se parandalimi më i mirë nga sulmet mbi gazetarët në të ardhmen është vendosja e një mekanizmi institucional efikas për dënim të ashpër të sulmuesve. Në gjashtë vitet e fundit SHGM-ja ka regjistruar mbi 50 sulme mbi gazetarët, kurse asnjë prej kryerësve nuk është dënuar.<sup>15</sup>

Më 25 shtator filloi fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale i ka informuar me shkresë radiodifuzerët se do të vazhdojë me monitorim të prezantimit të zgjedhjeve nga mediat, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor që zbatohen gjatë fushatës zgjedhore.<sup>16</sup> Në këtë shkresë janë renditur saktësisht detyrat që i kanë radiodifuzerët të cilët i mbulojnë zgjedhjet lokale në këtë periudhë të procesit zgjedhor.

Raporti i katër dhjetëditor nga monitorimi i informimit në media, për periudhën 6 deri në 15 shtator 2017, i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dëshmon se shumica e televizioneve dhe radiove u përmbahen standardeve profesionale, disa prej tyre duke marrë pozitë kritike ndaj pushtetit. Megjithatë, në periudhën e raportit, te disa shërbime të programit u konstatua anashkalim nga këto standarde. Është thënë se “Shërbimi i programit të parë të Radiotelevizionit të Maqedonisë – RTM 1, gjatë informimit për partitë politike, fokusohet tërësisht te dy partitë më të mëdha – nga opozita dhe nga pushteti, dhe pothuajse nuk informon për partitë e tjera/kandidatët e pavarur, të cilët, gjithashtu, përgatitën listë të kandidatëve dhe kanë aktivitete të tjera. Mënyra e informimit e TV Alfa dhe TV Nova, dëshmon, përsëri, shkelje të parimit të informimit objektiv dhe të paanshëm të ngjarjeve me trajtim të njëjtë të mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme, kurse vihen re edhe elementë të cilët ndikojnë lidhje të mundshme të politikave të redaksisë – sidomos në mënyrën e trajtimit të temës së

<sup>15</sup><http://znm.org.mk/?p=3733>

<sup>16</sup>[http://trinity.mk:53000/wpcontent/uploads/2017/09/lzvestuvanje\\_do\\_radiodifuzeri\\_monitoring\\_vo\\_izborna\\_kompanija.pdf](http://trinity.mk:53000/wpcontent/uploads/2017/09/lzvestuvanje_do_radiodifuzeri_monitoring_vo_izborna_kompanija.pdf)



migrantëve, largimin e investorëve të huaj nga Maqedonia, shpalljen e anketës demok nga QMBN-ja, e cila e mohon se e ka zbatuar etj.”<sup>17</sup>

Nga fundi i muajit, shumica e organizatave qytetare (Evrotink – Qendra për Strategji Evropiane, NVO Info-Qendra, Transparenca Maqedoni dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut) e prezantoi raportin e tretë monitorues mbi punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHAV) dhe Agjencisë për Komunikime Elektronike (AKE), në suazat e projektit “Monitorimi i efikasitetit, efektivitetit, transparencës dhe përgjegjësisë së trupave rregullatorë për mediat – PROformance Watch”. Ky raport i tretë tremujor është mbi punën e ASHAV-it dhe AKE-së në periudhën prill – qershor 2017 dhe është përparitur në bazë të “Matrica monitoruese e punës së ASHAV-it dhe AKE-së”, e krijuar në konsultim me dy trupat rregullatorë në janar 2017.

Në suazat e prezantimit, midis të tjerash thuhet se ASHAV mban një nivel solid të transparencës dhe raportimit, por se edhe në këtë tremujor jepet si mjaft e rëndësishme edhe çështja kryesore, nevoja për pavarësi të tërësishme politiko-partiake të ASHAV-it. Në këtë kuptim, është theksuar se Qeveria me Planin për reforma 3-6-9 e përshiu ASHAV-in përkatësisht paralajmëroi ndryshime të normativës ligjore në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të saj në bazë të meritave.<sup>18</sup>

Njëkohësisht, në këtë raport është shënuar ekzistimi i dallimeve në njohjen e gjuhës së urrëjtjes midis ASHAV-it, Prokurorisë Themelore Publike dhe Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD), si në rastin me emisionet në TV “Sitell” gjatë zgjedhjeve parlamentare 2016. Domethënë ajo që është gjuhë urrëjtje për ASHAV-in, për KMD-në është vetëm fushatë politike.<sup>19</sup>

## 2. Diskriminimi

Avokati i Popullit konstatoi diskriminim në bazë të gjinisë, seksit, shëndetit, paaftësisë dhe fesë në tekstin e librit shkollor “Edukimi qytetar” për klasën e 8-të. Në ankesën e paraqitur nga Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi në lidhje me përmbajtjen diskriminuese në libër, thuhet se në përmbajtjen e një prej mësimëve në këtë libër shkollor bëhet përpjekje për të shpjeguar të drejtat e grave nëpërmjet prizmit të fesë, me një citat i cili përfshin bindjen e gruas ndaj burrit, e cila përveç faktit se është diskriminim i bazuar mbi fenë dhe bindjen fetare, inkurajon dhe promovon diskriminim ndaj grave dhe paragjykime gjinore. Përveç kësaj, kjo përbën një shkelje të parimit të sekularizmit në arsim, sepse tekstet fetare paraqiten si burime të ligjshme të informacionit mbi të drejtat e grave, duke u kryer kështu diskriminim në bazë të fesë dhe bindjeve fetare ndaj grave dhe nxënësve që u përkasin feve të tjera ose nuk janë fetarë.<sup>20</sup> Pas zbatimit të procedurës dhe diskriminimit të përcaktuar, Avokati i Popullit i paraqiti Ministrisë së Arsimit një Rekomandim për mënyrën e realizimit të shkeljeve të konstatuara me

<sup>17</sup>[http://trinity.mk:53000/wp-content/uploads/2017/09/Izvestaj\\_od\\_monitoring\\_za\\_period\\_od\\_6-15\\_septemvri\\_2017\\_godina.pdf](http://trinity.mk:53000/wp-content/uploads/2017/09/Izvestaj_od_monitoring_za_period_od_6-15_septemvri_2017_godina.pdf)

<sup>18</sup><http://eurothink.mk/news/MLBQK7cCq57am35Mq>

<sup>19</sup>Tekstin e integruar të raportit e gjeni në këtë vegëz <http://eurothink.mk/gridfs/data/id/c1a0cb9ec3fbe51e998d9947>

<sup>20</sup><http://mhc.org.mk/announcements/631?locale=mk#.WdIkI2iCzIU>



udhëzime konkrete për të ndërmarrë veprime ministria e resorit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës i pranoi rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe mori vendim për tërheqje nga përdorimi të librit shkollor të kontestuar.<sup>21</sup> Komiteti i Helsinkit, i cili e inicioi rastin, e mirëpriti mendimin e Avokatit të Popullit dhe vendimin për tërheqjen e tekstit nga përdorimi nga ministrja e arsimit dhe bëri thirrje që praktika e tillë të vazhdojë dhe në të ardhmen për të gjitha tekstet shkollore që përmbajnë përmbajtje diskriminuese.

Gjatë muajit shtator u regjistrua edhe rasti në të cilin drejtori i shkollës fillore “Vëllazërim dhe Bashkim” nga Ohri u ndaloi dy motrave - nxënëse në klasën e tetë, të ndjekin mësimet sepse kishin veshur një shami në kokë. Avokati i Popullit reagoi me dënim për procedurën te Ministria e Arsimit, e cila nëpërmjet shkresës i mundësoi drejtorit të shkollës fillore "Vëllazërimi dhe Bashkim" nga Ohri t'u ndalonte ndjekjen e mësimëve nxënësve dhe kërkoi që atyre t'u mundësohet menjëherë ndjekja e mësimet. Në reagimin e Avokatit të Popullit theksohet nevoja për respektim të ligjeve dhe zbatimi i domosdoshëm i akteve ndërkombëtare të ratifikuara, si pjesë e sistemit tonë juridik dhe thuhet se “Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashikojnë dhe lejojnë lirinë e fesë dhe lirinë e shprehjes së fesë, kurse sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, liria e manifestimit të fesë vetëm mund të futet në kufizimet e parapara me ligj, kurse kufizimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin për Arsim Fillor dhe me dispozitat e tjera pozitive ligjore.”<sup>22</sup> Ministria e Arsimit dhe Shkencë reagoi nëpërmjet shpalljes, ku theksohet se shkresa e tyre dërguar drejtorit të shkollës është interpretuar gabim. Në shpallje thuhet se me shkresë (dërguar pasi prindi i nxënësve i është drejtuar MASH-it për mendim rreth rastit) nuk i jep lejë drejtorit të shkollës që t'i ndalojë nxënëset të vijnë në mësimin sepse mbajnë shami, por vetëm tregohet obligimi i shkollës fillore dhe i kompetencës dhe përgjegjësisë së drejtorit të shkollës në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të nxënësve.<sup>23</sup>

### 3. Institucione të mbyllura

Pas iniciativës së Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë, më 11 shtator 2017 drejtoresha ekzekutive e Komitetit të Helsinkit, Uranija Pirovska, Avokati i Populli, Ixhet Mexhiti dhe kryeministri Zoran Zaev, së bashku me delegacionin e resurseve përkatëse në Qeverinë e RM-së, duke përfshirë edhe drejtorin e Drejtorisë për Zbatim të Sanksioneve në Minsitrinë e Drejtësisë, Jovica Stojanoviq, bënë vizitë në shtëpinë ndëshkuese-edukuese “Idrizovë” me qëllim që të shihet gjendja në burgun më të madh në shtet.

Gjatë vizitës, drejtoresha ekzekutive e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Uranija Pirovska, theksoi shumë aspekte të funksionimit të keq të këtij institucioni ndëshkues-edukues dhe në përgjithësi

<sup>21</sup><http://mhc.org.mk/announcements/633?locale=mk#.WdluZ2iCzIU>

<sup>22</sup><http://www.slobodenpecat.mk/hronika/ohrid-direktorot-im-zabranil-na-osmoodelenki-da-posetuvaat-nastava-shamija/>

<sup>23</sup><https://www.slobodenpecat.mk/drustvo/mon-pogreshno-protolkuvan-dopisot-za-shamiite-vo-uchilishtata/>



për sistemin e burgjeve në shtet, si korrupsioni, por edhe e menaxhimi i burgjeve duhet t'u besohet njerëzve profesionalë.<sup>24</sup>

Avokati i Popullit tha se prej dymbëdhjetë vjetësh alarmon dhe kërkon zgjidhje për përmirësimin e kushteve katastrofale në burgje, si dhe se praktika e deritanishme në miratimin e planeve aksionare është dëshmuar si zgjidhje e keqe e cila nuk ka dhënë rezultate konkrete, sepse nuk ka përmirësim të kushteve hapësinore-materiale, sistemi shëndetësor është shkatërruar dhe mungojnë kadro profesionalë. Ai, theksoi se në burgje ka sistem jofunksional të risocializimit i cili në vend që të japë rezultatet e parashikuara krijon përsëri kriminelë që kthehen, kurse prej të miturve krijon kriminelë, të cilët shtëpitë edukuese-korrigjuese i zëvendësojnë me institucionet dënuese-korrigjuese. Ai theksoi se: “Kushtet në burgje e shkelin dinjitetin njerëzor. Republika e Maqedonisë është në fund, unë do të thosha nën fund kur bëhet fjalë për kushtet dhe trajtimin e personave të gjykuar. Prandaj shpresoj se në periudhën e ardhshme me një qasje serioze do të fillojnë të përmirësohen të gjitha segmentet e sistemit të burgjeve.”<sup>25</sup>

Pas vizitës së bërë, kryeministri Zoran Zaev deklaroi se i vjen turp që është kryeministër i një shteti ku ka burgje me kushte substandarde dhe çnjerëzore nën dinjitetin njerëzor dhe se do të përpiqet, me ndihmë të mediave, të nxisë debatin në shoqëri me qëllim që këto kushte të përmirësohen urgjentisht. Ai shtoi se një nga opsionet (që është vetëm në drejtim të restaurimit të objekteve të mbingarkuara në “Idrizovë”) është vetë debati i filluar brenda institucioneve për amnisti të një pjesë të të burgosurve nëpërmjet modelit të ndërprerjes së 30% të dënimit të përgjithshëm, por edhe nëpërmjet modeleve të tjera për veprat penale ku kjo është e lejuar, por jo edhe për format e rënda të krimit, për pedofilinë dhe për krimet kundër njerëzimit. Kryeministri shtoi se në disa pjesë të burgut duhet prishen sepse nuk mund të rinovohen. Në lidhje me pyetjen e medimeve se ku janë mjetet e kredisë (prej 46 milionë eurosh), të marrë para 7-8 vitesh nga Banka Evropiane Investuese për ndërtimin e burgut të ri në Idrizovë, kryeministri ia la fjalën projektueses të burgut të ri që duhej të ndërtohej. Ajo tha se rinovimi ka nisur në vitin 2014 dhe sipas saj vetëm disa objekte kanë filluar apo përfunduar, kurse pjesa më e madhe e burgut të shkatërruar nuk është prekur ende.”<sup>26</sup>

Dhjetë ditë më vonë, më 21 shtator 2017, përfaqësues të Komitetit të Helsinkit kryen vizitë në spitalin psikiatrik “Shkup” në Bardovcë, ku e vizituan dhe të pastrehun Muarem Demirov. Me këtë rast, Komiteti i Helsinkit shprehu shqetësim serioz për gjendjen shëndetësor të Demirovit, të cilit edhe pse i është konstatuar gangrenë në të dyja këmbët, tashmë prej tre muaj e gjysmë është vendosur në këtë institucion psikiatrik.

Domethënë, edhe përkrah premtimit të ministrit të shëndetësisë të dhënë më 5 qershor 2017 se pacienti Muarem Demirov do të hospitalizohet në ISHP Klinika për Kirurgji Torakale Vaskulare dhe do të

<sup>24</sup><http://www.mhc.org.mk/announcements/632?locale=mk#.WdlvLWiCzIU>

<sup>25</sup>[http://ombudsman.mk/MK/aktivnosti/241424/narodniot\\_pravobranitel\\_g\\_idzhet\\_metei\\_premierot\\_g\\_zoran\\_zaev\\_i\\_izvrshniot\\_direktor\\_na\\_helsinshkiot\\_.aspx](http://ombudsman.mk/MK/aktivnosti/241424/narodniot_pravobranitel_g_idzhet_metei_premierot_g_zoran_zaev_i_izvrshniot_direktor_na_helsinshkiot_.aspx)

<sup>26</sup><https://sdk.mk/index.php/makedonija/se-sramam-shto-sum-premier-na-zemja-vakvi-zatvori-kazha-zaev-po-uvidot-vo-idrizovo/>



vendoset në programin urgjent për intervenim përkatës, kurse pas përfundimit të intervenimit postoperativ do të vendoset në ISHP Enti Gjerondologjik “13 Nëntori” ku do t’i mundësohet shërim i tërësishëm, më 8 qershor 2017 i njëjti është hospitalizuar në Bardovci, pa u kryer operimi dhe pa pasur kushte për kujdes përkatës shëndetësor. Është e rëndësishme se personi Muarem Demirov nuk ka çrregullime psikike dhe si rrjedhim ai nuk mund të mbahet edhe mandej në ISHP Spitali Psikiatrik “Shkup”.<sup>27</sup>

#### 4. Masa kundër racizmit dhe ksenofobisë

Gjatë muajit shtator, në publik vazhdoi debati publik i ndjekur me nivel të lartë të gjuhës ksenofobie të urrejtjes ndaj migrantëve, duke i barazuar me terroristët, me mesazhe ofenduese dhe poshtëruese të cilat bëjnë thirrje për ndalimin e vendosjes së tyre në shtet. Në fjalimet e udhëheqjes më të lartë të VMRO-DPMNE-së, duke përfshirë edhe kryetarin e saj, Nikolla Gruevskin, lidhur me migrantët, komunikologët dalluan mesazhe indirekte ksenofobie dhe diskriminuese.<sup>28</sup> Në një nga fjalimet e veta, lideri i partisë opozitare VMRO-DPMNE theksoi se në vend të fabrikës së re e cila do t’i punësojë njerëzit nga Maqedonia, Qeveria ka bërë plan për integrim të migrantëve në procesin mësimor, kurse në vend që të krijojë kushte për hapjen e vendeve të reja të punës për të rinjtë, ajo ka bërë strategji për gjetjen e zgjidhjeve për punësim të migrantëve. U ngritën disa iniciativa qytetare, për mbledhjen e nënshkrimeve të qytetarëve kundër vendosjes së migrantëve, të cilët nxisnin dhe provokonin vazhdimisht gjuhë të urrejtjes. Në Koçani, Shtip, Gjevgjeli, Kavadarci, Negotinë, Veles, Manastir, Prilep, Radovish, Ohër dhe në komunat e Shkupit “Gazi baba”, “Aerodrom” dhe “Karposh” u morën vendime për mbajtje të referendumit (i cili planifikohej të mbahej në ditën e zgjedhjeve lokale, 15 tetor) ku qytetarët do të shpreheshin pro apo kundër vendosjes dhe integritit të migrantëve në këto komuna.

Edhe pse ngritja e iniciativave qytetare dhe shpallja e referendumit për marrje të mendimit të qytetarëve janë mekanizma të lejuar demokratikë dhe ligjorë, por është e domosdoshme që ata të mos provokojnë dhe nxitin urrejtje ndaj një grupi të caktuar qëllimor, në këtë rast migrantët.<sup>29</sup> Pikërisht për këtë arsye, Komiteti i Helsinkit paralajmëroi se shpërhapja dhe nxitja e vazhdueshme e gjuhës së urrejtjes ndaj migrantëve, mund të çojë lehtë drejt kryerjes së veprave nga urrejtja dhe rikujtoi se nga fillimi i vitit 2015 dhe deri më tani Komiteti i Helsinkit ka regjistruar 34 vepra nga urrejtja të kryera ndaj migrantëve apo refugjatëve në Republikën e Maqedonisë.<sup>30</sup>

Ministrja e punës dhe politikës sociale, Milla Carovska mori pjesë në seancën e Këshillit të Komunës Manastir, ku theksoi se partia politike VMRO-DPMNE shpërhap ksenofobi dhe lajme të rrejshme. Ajo theksoi se nuk do të ndërtojnë banesa për migrantët në Republikën e Maqedonisë dhe kërkoi nga VMRO-DPMNE-ja të thotë se me cilin dokument Qeveria ka marrë për obligim të shpenzojë mjete financiare ose ka bërë dokumente projektuese për ndërtimin e banesave, duke theksuar se “kjo strategji nuk është për migrantët, përkundrazi rezolutën e miratuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për

<sup>27</sup><http://www.mhc.org.mk/announcements/639?locale=mk#.WdVxI7puJPZ>

<sup>28</sup><https://www.slobodnaevropa.mk/a/28719864.html>

<sup>29</sup><http://www.mhc.org.mk/announcements/630?locale=mk#.Wdlu-WiCzIU>

<sup>30</sup><http://www.zlostorstvaodomraza.mk/reports#>



migrantët e votoi shumica e VMRO-DPMNE-së.” Ajo theksoi se referendumi është e drejtë demokratike dhe se beson në shprehjen e qytetarëve për çështje të rëndësishme me referendum, por kjo çështje është e rremë.<sup>31</sup>

Megjithatë, Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale mori vendim që të ndërpriten vendimet për organizim të referendumeve lokale në komunat për migrantët ditën e zgjedhjeve lokale, 15 tetor, dhe të ngrejë procedurë para Gjykatës Kushtetuese për përcaktim të ligjshmërisë. Komisioni Shtetëror Zgjedhor kërkoi nga 12 komunat të ndalojnë me aktivitetet e tyre për përgatitje dhe organizim të referendumeve lokale për migrantët deri në marrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje.<sup>32</sup>

---

<sup>31</sup><http://faktor.mk/carovska-se-pojavi-na-sednica-na-sovet-vo-bitola-nitu-kje-se-naseluvaat-begalci-nitu-kje-se-gradat-stanovi>

<sup>32</sup><http://fokus.mk/dik-ne-mozhe-referendum-i-lokalni-izbori-vo-ist-den/>